



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

V E N D I M

Nr. 47, dt. 23.12.2024

**MBI MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PËRFUNDIMTAR
2025-2027 PËR KËSHILLIN E QARKUT**

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, Ligjit Nr.9936, dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes të PBA të njësive të vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.3 dt.28.02.2024 “Për përgatitjen e Programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027, udhëzimit plotësues nr.8 dt.05.07.2024 “Për përgatitjen e Programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027” Ligjit “Për buxhetin e vitit 2025”, Udhëzimit nr 7 datë 25.02.2022 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 23 datë 30.07.2018, me propozim të Kryesësë, Këshilli i Qarkut Korçë

V E N D O S I

1. Të miratojë tavanet përfundimtare për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 përfundimtar.
2. Të miratojë dokumentin përfundimtar të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 për Këshillin e Qarkut Korçë, të përgatitur sipas Sistemit të Menaxhimit të Buxhetit Vendor(SMBV).
3. Të miratojë relacionin shpjegues për procesin e përgatitjes së dokumentit përfundimtar të PBA 2025-2027.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Ekipet e menaxhimit të programeve, si dhe gjithë administrata e Këshillit të Qarkut.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit të Prefektit.

KRYETARI
Erjon Nexhipi



Miratuar me / 19 / Vota
Vota Pro / 19 /
Vota Kundër / 0 /
Vota Abstenim / 0 /
Zbardhur më datë /23/12/2024
Konceptoi O. Beqiraj
Juristi M.Bylykbashi
Sek. K. Qarkut B. Muço